

E drejta për natyralizim

Personat me status të mbrojtjes ndërkombëtare dhe personat me status të personit pa shtetësi kanë të drejtë në fitimin e shtetësisë së Kosovës mbi bazën e natyralizimit.

Shtetësia fitohet në përputhje me Ligjin në fuqi për Shtetësinë e Kosovës dhe Rregulloren për Integrimin e të huajve.

Ndihma Juridike Falas

Ju keni të drejtë në ndihmë juridike falas në qoftë se nuk keni mjete të mjaftueshme financiare për mbulimin e shpenzimeve.

Ju mund të merrni informata në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga njohja e statusit tuaj si dhe ndihmë juridike dhe këshilla për çdo kërkesë tjetër ligjore që mund të pasojë.

Ju mund të asistoheni për hartimin e kërkesave dhe ankesave dhe të përfaqësoheni para autoriteteve kompetente në rast të ndërprerjes, anulimit ose revokimit të statusit të mbrojtjes ndërkombëtare, mbrojtjes së përkohshme apo statusit të personit pa shtetësi.

Ndihma juridike falas mund t'ju ofrohet nga avokatët, organizatat që merren me të drejtat e refugjatëve ose nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

DETYRIMET TUAJA NË KOSOVË

Ju keni vetëm dy detyrime kryesore:

1. Që të respektoni Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Kosovës, dhe
2. Të informoni Ministrinë e Punëve të Brendshme për çdo ndryshim të adresës brenda shtatë ditëve.



Ndihma Juridike Falas

Programi për të Drejtat Civile - Kosovë (CRP/K)
Tel: +383(0) 38 243- 610/611 / Email: crp@crpkosovo.org
Rruga Lorenc Antoni nr.15
Qyteza Pejton
10000 Prishtine, Republika e Kosovës
CRP/K është një organizatë joqeveritare lokale, partner i UNHCR-së.

Ndihma psiko-sociale

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)
Rr. 'Hamëz Jashari' 16b/2, Lagjja Dodona, Prishtinë 10000
+383 (0)38 243 707; E-mail: info@krct.org
QKRMT është një organizatë joqeveritare lokale, partner i UNHCR-së

KË MUND TA KONTAKTONI?

Ministria e Punëve të Brendshme
Departamenti për Riintegrimin e Personave
të Riatdhesuar (DRPR)
Tel: +383 (0) 38 521 266
Centrex: +383 (0) 200 19 810
Adresa: Rr. "Luan Haradinaj" p.n. Prishtinë

Departamenti për Shtetësi Azil dhe Migracion (DSHAM)

Tel: + 383 38 200 19 596
Adresa: Rruga. "Luan Haradinaj" p.n.

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas:

Tel: 038 200 18 941; 038 200 18 950
Emaili: info.anjf@rks-gov.net
Zyra në Prishtinë: Rruga "Zenel Salihu " nr 30.

Financuar nga UNHCR

BROSHURË INFORMATIVE PËR PERSONAT ME STATUS TË MBROJTJES NDËRKOMBËTARE, MBROJTJES SË PËRKOHSHME DHE PËR PERSONAT ME STATUS TË PERSONIT PA SHTETËSI NË KOSOVË

*Ne jemi të kënaqur që ju kemi në shtetin tonë,
shpresojmë të ndiheni si në shtëpinë tuaj!*

*Ne të gjithë jemi njerëz.
Ne kemi të drejta dhe detyrime.*

Ju meritoni të jetoni një jetë të mirë!

Ju jeni të njëjtë si të gjithë të tjerët!



Të drejtat tuaja janë të garantuara me Ligjin për Azil, Ligjin për të Huajt dhe Ligjin për Shtetësinë e Kosovës, dhe do të trajtoheni si qytetar i Kosovës gjatë kohës së qëndrimit në Kosovë.

TË DREJTAT TUAJA NË KOSOVË

E drejta për qëndrim

Ju keni të drejtë të qëndroni në Republikën e Kosovës për aq kohë sa ju është dhënë statusi i mbrojtjes ndërkombëtare, mbrojtjes së përkohshme apo statusi i personit pa shtetësi.

E drejta për integrim

Ju keni të drejtë në të gjitha skemat e integritimit në Republikën e Kosovës sipas aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare, të cilat janë të përcaktuara me Rregulloren për integrimin e të huajve.

Informimi

Ju keni të drejtë të informoheni në gjuhën tuaj apo në gjuhën të cilën e kuptoni, për të drejtat dhe detyrimet tuaja si dhe për procedurat, pjesë e të cilave mund të jeni.

Qasja në dokumentet personale

Ju duhet të pajiseni paraprakisht me dokumente personale që të keni të drejtë të përfitoni nga masat e integritimit, si në vijim:

• **Leja e qëndrimit (letërnjoftimi)**

Juve ju takon leja e qëndrimit si dhe anëtarëve të familjes suaj, si përfitues të bashkimit familjar.

Një kërkesë për leje të qëndrimit duhet të paraqitet personalisht në Divizionin për të Huajt pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

• **Dokumenti i udhëtimit**

Ju keni të drejtë të posedoni dokument udhëtimi. Një kërkesë për dokument udhëtimi duhet të paraqitet personalisht në Divizionin për të Huajt pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kur personi është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjet, aplikimi duhet të bëhet nga përfaqësuesi ose kujdestari i tij/saj ligjor.

• **Fletëudhëtimi**

Fletëudhëtimi iu lëshohet personave me mbrojtje plotësuese dhe me mbrojtje të përkohshme të cilët nuk janë në gjendje të marrin një pasaportë kombëtare, e cila iu mundëson udhëtimin jashtë shtetit. Një kërkesë për fletëudhëtim duhet të paraqitet personalisht në Divizionin për të Huajt pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.



MASAT PËR INTEGRIMIN PAS MARRJES SË STATUSIT

Qasja në regjistrin e gjendjes civile

Ju keni të drejtën e qasjes në regjistrin e gjendjes civile në komunën ku qëndroni, në mënyrë që të dëshmoni dhe vërtetoni lindjen, statusin familjar, vdekjen, marrëdhëniet ndërmjet jush dhe çdo ndryshim që mund të ndodh në këto marrëdhënie.

Strehimi elementar/Akomodimi

Ministria e Punëve të Brendshme do të siguroj strehim deri në dy (2) vjet për personat me status të mbrojtjes ndërkombëtare dhe mbrojtjes së përkohshme, të cilët nuk kanë mjete financiare për të mbuluar kostot e akomodimit, nga data e marrjes së vendimit për njohjen e statusit.

Qasja në banimin social

Strehimi bazik (elementar) në banimin social u ofrohet personave të cenueshëm nga kategoria e personave me status të mbrojtjes ndërkombëtare, mbrojtjes së përkohshme dhe personave me status të personit pa shtetësi nga komunat përkatëse dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kujdesi shëndetësor, arsimi dhe integrimi në shoqëri, janë disa nga të drejtat e shumta që ju do të mund t'i gëzoni në mënyrë që të ndiheni i/e qetë në vendin tonë.

Arsimimi


Ju keni të drejtën e qasjes në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, me të njëjtat kushte si të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës në institucionet publike.

Integrimi

Ju gjithashtu do të mësoni dhe njiheni me gjuhën, kulturën, historinë, traditat dhe rregullat e shtetit tonë, në kuadër të të gjitha të drejtave që do t'i gëzoni.

Liria e mendimit dhe besimi fetar

Ju keni të drejtë të ushtroni dhe të shprehni lirshëm mendimin dhe besimin tuaj fetar, pa u diskriminuar.



E drejta e punësimit

Ju keni të drejtë të punoni në Republikën e Kosovës pa leje pune për të huajt dhe po ashtu keni të drejtën e praktikës së formimit profesional për përvojë pune, në të njëjtat kushte si qytetarët e Kosovës. Ne ju ofrojmë mikpritjen tonë që të mund të punoni dhe të jeni pjesë e shoqërisë, pa pasur ndonjë kufizim. Ju jeni të lirë të rritni aftësinë tuaj në komunitet si dhe të kontribuoni në zhvillimin e komunitetit.

Ndihma sociale

Sipas Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, personat me status të mbrojtjes ndërkombëtare dhe mbrojtjes së përkohshme kanë të drejtë në ndihmë sociale.

Një kërkesë për ndihmë sociale duhet të paraqitet personalisht në Qendrën për Punë Sociale në komunën tuaj përkatëse.

Bashkimi familjar

Ju keni të drejtë për bashkim familjar në Republikën e Kosovës. Një kërkesë për të inicuar procedurën e bashkimit familjar duhet të paraqitet personalisht në Divizionin për të Huajt pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Qasja në Drejtësi

Ju keni të drejtën e qasjes në Gjykatat Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme të Kosovës.

E drejta që të keni pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme

Personat me status të mbrojtjes ndërkombëtare dhe personat me status të personit pa shtetësi kanë të drejtë të posedojnë pronë të luajtshme dhe të paluajtshme me të njëjtat kushte sikurse personat e huaj.

• Ju duhet të informoheni më në detaje nga zyrtarët e DRPR-së për të përfituar nga masat e integritimit.-

